

37303

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË  
Nr. \_\_\_\_\_ Vendimit

V E N D I M  
P Ë R  
RREGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK

Sot më datë 25/01/2007, unë Teuta HOXHA Gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi mora në shqyrtim kërkesën e kërkuarit Roland Kocli, i cili më kërkoi regjistrimin e Shoqërisë Tregtare "ALBIT CONSTRUCTION" Sh.p.k. si Person Juridik Privat,

K O N S T A T O V A S E :

Kërkuari Roland Kocli, në cilësinë e administratorit, kërkon të regjistrojë Shoqërinë Tregtare "ALBIT CONSTRUCTION" Sh.p.k. me seli në Qytetin e Laçit, me adresë Rruga e Patokut dhe me objekt të veprimtarisë si më poshtë:

- Prodhimi dhe tregtimi i materialeve të ndërtimit, si beton, granile, gëlqere, etj, i materialeve inerte dhe e të gjitha materileve të tjera që përdoren në ndërtim;
- Import-eksporti i tyre brenda dhe jashtë vendit për llogari të vetë shoqërisë dhe të tretëve;

Veprimtaria e shoqërisë do të kryhet në përputhje me lejet dhe licencat e lëshuara nga organet kompetente shtetërore.

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë në vlerën 100.000 (një qindmijë) lekë, i përkërë nga 100 kuota me vlerë nominale 1000 lek secila. Ortak themelues të Shoqërisë do të jenë Z.Paolo Panico dhe Z. Roland Kocli, të cilët do të zotërojnë kapitalin themeltar në këtë mënyrë:

- Z. Paolo Panico., me cilësinë e ortakut themelues, zotëron 95% të kuotave ose 95 kuota të barabarta me vlerë të përgjithshme 95 000 Lekë në kapitalin themeltar.
- Z. Roland Kocli, me cilësinë e ortakut themelues, zotëron 5% të kuotave ose 5 kuota të barabarta me vlerë të përgjithshme 5 000 Lekë në kapitalin themeltar.

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pa kufizuar. Administrator i Shoqërisë do të jetë Z. Roland KOCLI.

Për sa më sipër kërkesa e bërë prej tyre është plotësisht e bazuar në ligj dhe si e tillë duhet të pranohet.



P Ë R K Ë T O A R S Y E :

Në bazë të ligjit nr.7638 datë 10.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe ligjit nr.7667 datë 28.1.1993 "Për Regjistrin Tregtar",

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA E NOTERISË TIRANË

Nr. 2240 Rep.

Nr. 420 Kol.



**KONTRATË THEMELIMI  
PËR SHOQËRINË TREGTARE  
ME SELI NË LAÇ**

**“ALBIT CONSTRUCTION” SH.P.K.**

Sot, më datë 12/01/2007 (dymbëdhjetë Janar dymijë e shtatë), para meje Neriman Marika, notere e Dhomës së Noterisë Tiranë, me seli në Rrugën “Ded Gjo Luli”, u paraqitën palët e mëposhtme:

1. **Paolo Panico**, shtetas Italian, i datëlindjes 16 Mars 1970, lindur në Santa Marza Capua Vetere (CE), person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. F 996566.
2. **Roland Kocli**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 24 dhjetor 1978, lindur dhe banues në Rrasfik, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. Z 0305980.

të cilët me kërkuan redaktimin e kësaj kontrate themelimi me termat si më poshtë vijon:

**NENI 1**

SHOQËRIA TREGTARE “ALBIT CONSTRUCTION” SH.P.K. themelohet si Shoqëri Tregtare, bazuar në ligjin Nr.7638 datë 9.11.1992 “Për Shoqëritë Tregtare”.

Veprimtaria e Shoqërisë bazohet në normat e kësaj kontrate themelimi, Statutit të Shoqërisë, si dhe Legjislacionit Shqiptar në fuqi.

Shoqëria fiton personalitet juridik pas regjistrimit të saj si Person Juridik Privat në Regjistrin Tregtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**NENI 2**

**EMËRTIMI**

Shoqëria do të paraqitet në qarkullim juridiko – civil me emërtimin e saj “ALBIT CONSTRUCTION” SH.P.K.

### **NENI 3 OBJEKTI**

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj aktivitetin në fushën:

Prodhimi dhe tregtimi i materialeve të ndërtimit, si beton, granile, gëlqere, etj, i materialeve inerte dhe e të gjitha materialeve të tjera që përdoren në ndërtim;  
Import-eksporti i tyre brenda dhe jashtë vendit për llogari të vetë shoqërisë dhe të tretëve.

### **NENI 4 SELIA**

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën Rruga e Patokut, Laç.

### **NENI 5 KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar i Shoqërisë është i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues në vlerën 100.000 (njëqindmijë) LEK, i ndarë në 100 (njëqind) kuota me vlerë nominale të një kuote 1000 (njëmijë) lekë.

Kuotat e kapitalit themeltar të Shoqërisë janë të ndara si më poshtë :

1. **Z. Paolo Panico**, me cilësinë e ortakut themelues, zotëron 95% të kuotave ose 95 kuota të barabarta me vlerën 95.000 lekë, në kapitalin themeltar.
2. **Z. Roland Kocli**, me cilësinë e ortakut themelues, zotëron 5% të kuotave ose 5 kuota të barabarta me vlerën 5.000 lekë, në kapitalin themeltar.

Kapitali themeltar është investuar nga Ortakët Themelues në tërësinë e tij dhe në përpjestim me pjesët takuese të secilit. Vlerësimi dhe shlyerja e kapitalit themeltar është bërë nga Ortakët Themelues me rastin e miratimit të kësaj kontrate themelimi dhe është nënshkruar prej tyre.

### **NENI 6 SHLYERJA E KAPITALIT THEMELTAR**

Shoqëria ka të depozituar në Bankën Banka Popullore kapitalin në të holla, i cili depozitohet në llogarinë "Shoqëri në Formim e Sipër" në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate themelimi.

Pas regjistrimit të Shoqërisë, kjo shumë do të kalojë në llogarinë e kësaj Shoqërie që do të çelet pranë Bankës "Banka Popullore".

Në llogarinë e Shoqërisë çelet llogaria "Fondi Themeltar i Ortakëve" ku regjistrohet sasia e kapitalit të tyre.

### **NENI 7 KOHËZGJATJA E SHOQËRISË**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një afat të pacaktuar. Afati i fillimit të veprimtarisë fillon pas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe mund të kufizohet,



më pas zgjatet, një ose më shumë herë, me vendim të Asamblesë së Jashtëzakonshme të ortakëve.

## **NENI 8 TËRHEQJA NGA SHOQËRIA**

Ortakët themelues mund të heqin dorë nga Shoqëria por gjithnjë për shkaqe të përligjura. Heqja dorë nuk i shkarkon Ortakët, nga detyrimet e Shoqërisë deri në momentin e heqjes dorë.

## **NENI 9 ORGANET DREJTUESE**

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asamblea e Ortakëve.
- Administratori.
- Eksperti kontabël (për rastet e parashikuara nga ligji)

Mënyra e organizimit dhe funksionimit të tyre është përcaktuar në Statutin e Shoqërisë. Shoqëria do të administrohet nga **Z. Roland Kocli**, që do të qëndrojë në detyrë deri në dorëheqjen ose shkarkimin e tij.

Administratori ka të gjitha kompetencat për administrimin e zakonshëm të shoqërisë, në përputhje me sa është parashikuar nga ligji, kontrata e themelimit dhe Statuti.

Ai gëzon të drejta dhe fuqi të plota për kryerjen e çdo veprimi që vlerësohet i dobishëm për realizimin e objektivave të shoqërisë, me përjashtim të atyre që kërkojnë miratimin paraprak të asamblesë së ortakëve.

## **NENI 10 PJESËMARRJA NË SHOQËRI TË TJERA**

Ortakët mund të vendosin me vullnetin e tyre për pjesëmarrjen në shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, por jo konkruues me atë të shoqërisë së themeluar prej tyre.

## **NENI 11 LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM**

Veprimtaria e shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e Statutit të nënshkruar nga ortakët dhe të vërtetuar prej meje noteres në ditën e redatimit të kësaj kontrate themelimi, si dhe nga dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

## **NENI 12 ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet ortakëve ose ndërmjet ortakëve dhe shoqërisë dhe që kanë objekt të drejta të disponueshme në lidhje me marrëdhëniet e tyre me shoqërinë do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.



**NENI 13  
DISPOZITA TË FUNDIT**

Kjo kontratë themelimi u përpilua në katër kopje në gjuhën shqipe dhe, pasi iu bë e njohur palëve në gjuhën italiane prej meje noteres, u nënshkrua pa vërejtje nga ortakët themelues të shoqërisë përpara meje noteres dhe unë e vërtetoj atë.

---

**ORTAKËT THEMELUES**

**Paolo PANICO**

*Paolo PL  
PL PL*

**Roland KOCLI**

*Roland Koeli KOKLI*

**NOTERE**

**Neriman MARIKA**

*. Notere  
. Neriman Marika*

*Përkthyesë*

*Flavieta Bala*

*Flavieta*

**STATUTI**  
**I**  
**SHOQËRISË TREGTARE**

**ME SELI NË LAÇ**  
**“ALBIT CONSTRUCTION” SH.P.K.**

Sot, më datë 12/01/2007 (dymbëdhjetë Janar dymijë e shtatë), ortakët themelues:

1. **Paolo Panico**, shtetas Italian, i datëlindjes 16 Mars 1970, lindur në Santa Marza Capua Vetere (CE), person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. F 996566.
2. **Roland Kocli**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 24 dhjetor 1978, lindur dhe banues në Rrasfik, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. Z 0305980.

kanë rënë dakort për hartimin e këtij Statuti, me terma si më poshtë vijon:

**I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Shoqëria Tregtare “ALBIT CONSTRUCTION” SH.P.K. rregullon pozitën e saj juridike, marrdhëniet e themeluesve, të organeve të saj, llojin e Shoqërisë, kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj, duke u bazuar në ligjin 7638 datë 19.11.1992 “Për Shoqëritë Tregtare”, dhe dispozitat e tjera të legjislacionit shqiptar në fuqi që rregullojnë marrdhëniet e Shoqërive Tregtare.

**NENI 1**  
**EMËRTIMI**


Themelohet një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin “ALBIT CONSTRUCTION” Sh.p.k. Shoqëria del në qarkullimin juridiko-civil me emërtimin e saj të plotë.

**NENI 2**  
**SELIA**

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën Rruga e Patokut, Laç.  
Shoqëria mund të krijojë seli dytësore, filiale, zyra përfaqësimi, degë ose agjensi si në Shqipëri ashtu edhe jashtë vendit.  
Vendbanimi i ortakëve për të gjitha marrëdhëniet me Shoqërinë është ai që rezulton nga libri i ortakëve dhe aktet e themelimit.

**NENI 3.**  
**REGJIMI JURIDIK I SHOQËRISË.**

Shoqëria udhëhiqet nga parimet e ekonomisë së tregut dhe ka për qëllim fitimin. Ajo respekton parimin e reciprocitetit.



Ajo është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (Sh.p.k.). Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të kontratës së themelimit, Statutit si dhe dispozitave të legjislacionit tregtar e atij civil në fuqi.

Me vendim të Ortakëve, Shoqëria mundet që të ndryshojë formën e regjimit juridik të saj në përputhje me dispozitat ligjore që do të jenë në fuqi si dhe në përputhje të plotë me dispozitat e Kontratës të Themelimit dhe të Statutit të saj, duke bërë edhe përshtatjen e tyre sipas ndryshimeve përkatëse.

Shoqëria gëzon personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në Rregjistrin Tregtar. Shoqëria do të ketë vulën e saj.

#### NENI 4 OBJEKTI

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj aktivitetin në fushën:

- Prodhimi dhe tregtimi i materialeve të ndërtimit, si beton, granile, gëlqere, etj, i materialeve inerte dhe e të gjitha materialeve të tjera që përdoren në ndërtim;
- Import-eksporti i tyre brenda dhe jashtë vendit për llogari të vetë shoqërisë dhe të tretëve.

Veprimtaria e shoqërisë do të kryhet në përputhje me lejet dhe liçensat e lëshuara nga organet kompetente shtetërore.

#### NENI 5 KOHËZGJATJA

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një afat të pacaktuar. Afati i fillimit të veprimtarisë fillon pas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar.

#### NENI 6 KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është përcaktuar në vlerën 100.000 Lekë (njëqindmijë) dhe është i ndarë në 100 kuota me vlerë nominale të një kuote 1 000 (njëmijë) Lekë.

Kuotat e shoqërisë janë të shpërndara ndërmjet ortakëve si më poshtë:

1. **Z. Paolo Panico**, me cilësinë e ortakut themelues, zotëron 95% të kuotave ose 95 kuota të barabarta me vlerën 95.000 lekë, në kapitalin themeltar.
2. **Z. Roland Kocli**, me cilësinë e ortakut themelues, zotëron 5% të kuotave ose 5 kuota të barabarta me vlerën 5.000 lekë, në kapitalin themeltar.

Të gjitha pjesët e kapitalit themeltar duhet që të nënshkruhen në tërësinë e tyre nga Ortakët themelues dhe të shlyhen krejtësisht prej tyre, si për rastet kur përfaqësojnë kontribute në para ashtu edhe në natyrë.

#### NENI 7

Ortakët mbajnë përgjegjësi për humbjet deri në kufirin e kapitalit të investuar. Pasuritë e krijuara nga Shoqëria gjatë aktivitetit të saj janë në pronësi të Ortakëve, në raport me përqindjet e kapitalit themeltar që ata zotërojnë. Ato (pasuritë) mund të tjetërsohen, të jepen me qera, të lihen peng e hipotekë me miratimin e Ortakëve.

## NENI 8

### ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT

Kapitali themeltar mund të zmadhohet ose të zvogëlohet kur për këtë vendosin Ortakët themelues.

Zmadhimi i kapitalit mund të vendoset kur e kërkojnë interesat e Shoqërisë duke vendosur kuotat suplementare të Ortakëve.

Ortakët themelues, vendosin për zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë. Zvogëlimi i kapitalit nuk duhet të dëmtojë kreditorët e as të krijojë pasiguri tek ata që kanë dhënë kredi para publikimit të zvogëlimit të kapitalit. Në të kundërtën Gjykata e konsideron të pavlefshëm këtë vendim mbi kërkesën e kreditorëve.

Në të gjitha rastet e zmadhimit apo zvogëlimit të kapitalit të shoqërisë janë të aplikueshme dispozitat e ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare", nenet 62 deri 64 të këtij ligji.

## NENI 9

Ndalohet emetimi i letrave me vlerë si dhe garantimi i emisioneve të letrave me vlerë.

## NENI 10

### TRANSFERIMI I KUOTAVE

Kuotat janë me vlerë nominale. Të drejtat, përfshirë edhe e drejta e votës, u takojnë ortakëve në mënyrë përpjestimore me kuotat që secili zotëron në kapitalin themeltar.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

Në rastin e transferimit të kuotave në favor të të tretëve, ortakëve të tjerë të shoqërisë u takon e drejta e parablerjes. Ortaku që dëshiron të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, kuotat e pjesëmarrjes së tij në shoqëri duhet t'ju komunikojë ortakëve të tjerë nëpërmjet letre rekomande, ofertën e marrë, duke treguar emrin e blerësit dhe kushtet e tjetërsimit, në mënyrë të veçantë çmimin e caktuar dhe modalitetet e pagesës.

Ortaku/ortakët e interesuar, brenda tridhjetë ditëve nga marrja dijeni, duhet t'i komunikojnë ortakut që tjetëron të drejtat, nëpërmjet letre rekomande, interesin për të ushtruar të drejtën e parablerjes, duke përfshirë, eventualisht, edhe interesin për blerjen e pjesës së kuotave për të cilën nuk është ushtruar e drejta e parablerjes nga ana e ortakëve të tjerë.

E drejta e parablerjes së kuotave objekt tjetërsimi ushtrohet përpjestimisht me pjesëmarrjen që zotëron secili nga ortakët në kapitalin themeltar dhe po në këtë mënyrë zmadhohet në favor të ortakëve të tjerë në rast se ndonjë nga ortakët që gëzon të drejtën e parablerjes heq dorë prej saj.

*Transferimet e kapitalit të shoqërisë duhet të vërtetohen me akt noterial, ndryshe janë të pavlefshme.*

## NENI 11

### TRASFERIMI I KUOTAVE TEK PASARDHËSIT, PARARDHËSIT DHE BASHKËSHORTI.

Kuotat e Ortakëve mund të transferohen lirisht tek trashgimtarët ligjore e testamentarë të tij mbas vdekjes si dhe tek bashkëshorti tjetër me rastin e zgjidhjes së martesës. Subjektet që





perfitojnë nga ky transferim detyrohen të disponojnë kapitalin e transferuar për një vit në Shoqëri, duke pasur të gjitha të drejtat e mbajtësit të tij të mëparshëm.

Ortakët mund të transferojnë lirisht kapitalin themeltar edhe tek bashkëshorti, tek pasardhësit e paraardhësit, të cilët detyrohen që për një vit ta disponojnë këtë kapital në shoqëri.

## NENI 12 HEQJA DORË

Kanë të drejtë të heqin dorë nga shoqëria ortakët që nuk kanë marrë pjesë në miratimin e vendimeve që kanë lidhje me:

- ndryshimin e objektit të shoqërisë;
- shndërrimin e shoqërisë;
- bashkimin dhe ndarjen e shoqërisë;
- anulimin e gjendjes në likuidim;
- transferimin e selisë së shoqërisë jashtë shtetit;
- eliminimin e një ose disa shkaqeve të heqjes dorë parashikuar nga ky statut;
- kryerjen e operacioneve që sjellin një ndryshim thelbësor të objektit të shoqërisë;
- kryerjen e operacioneve që sjellin një rritje të angazhimit të ortakëve në kapitalin themeltar të shoqërisë, sipas nenit 60, paragrafi i dytë ligjit Nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare";

E drejta e heqjes dorë ekziston në të gjitha rastet e tjera të parashikuara me ligj.

Ortaku që synon të heqë dorë nga shoqëria duhet t'i japë komunikim organit administrativ, me letër rekomande dërguar selisë së Shoqërisë. Në komunikimin e heqjes dorë duhet të tregohen gjeneralitetet e ortakut që heq dorë, vendbanimi i tij për komunikimet që lidhen me procedimin dhe të shkakut që justifikon heqjen dorë. Në mungesë, komunikimet kryhen në vendbanimin që rezulton nga libri i ortakëve.

Heqja dorë konsiderohet e ushtruar ditën në të cilën komunikimi ka arritur në selinë e shoqërisë. Për ushtrimin e së drejtës së heqjes dorë duhet të mbahet shënim në librin e ortakëve. Heqja dorë nuk mund të ushtrohet dhe, nëse është ushtruar, nuk është e vlefshme nëse, brenda nëntëdhjetë ditëve nga ushtrimi i heqjes dorë, shoqëria anullon vendimin që e legjitimon atë ose vendoset shpërndarja e shoqërisë.

Heqja dorë nuk i shkarkon ortakët nga detyrimet e shoqërisë deri në momentin e heqjes dorë.

## NENI 13 LIKUIDIMI I ORTAKËVE

Në rastet e parashikuara nga nenet 10 deri 12 të këtij Statuti, pjesëmarrjet do t'i rimbursohen ortakut ose trashëgimtarëve të tij në përpjestim me pasurinë përkatëse, nëpërmjet blerjes nga ana e ortakëve të tjerë, në përpjestim me kuotat përkatëse të secilit në kapitalin themeltar, ose blerjes nga ana e një të treti të përcaktuar me marrëveshje nga vetë ortakët.

Në rast se kjo nuk arrihet, rimbursimi kryhet duke përdorur rezervat në dispozicion ose, në mungesë, duke zvogëluar përpjestimisht kapitalin themeltar, në përputhje me kufirin minimal të lejuar nga ligji.

## NENI 14

### ASAMBLEA E ORTAKËVE

Organi themelor i shoqërisë është Asamblea e Ortakëve. Asamblea rregullisht e thirrur përfaqëson tërësinë e ortakëve dhe vendimet e saj të marra konform ligjit dhe këtij statuti janë të detyrueshme për të gjithë ortakët, edhe nëse mungojnë ose nuk janë të të njëjtit mendim.

Asamblea thirret nga administratori, edhe jashtë selisë së shoqërisë, brenda dhe jashtë vendit, me letër rekomande dërguar ortakëve, të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para datës së mbledhjes së asamblesë. Asamblea mund të thirret edhe nga eksperti kontabël i autorizuar, nëse janë emëruar të tillë, ose nga një ose disa ortakë që përfaqësojnë të paktën 10 për qind të pjesëve të kapitalit themeltar.

Ortakët kanë të drejtë të tërheqin të gjithë dokumentat kryesore të Shoqërisë për tre vitet e fundit si dhe të kërkojnë prej administratorit materialet e saj dhe projektet e vendimeve, 15 ditë para çdo mbledhje asambleje.

Vendimet e Asamblesë merren me shumicat e parashikuara nga nenet 59 dhe 60 të Ligjit Nr. 7638, datë 19.11.1992, "Për shoqëritë Tregtare", si dhe pasqyrohen rregullisht në procesverbalin e nënshkruar nga vetë ortakët.

Ortakët kanë të drejtë të marrin personalisht pjesë në asamble ose të përfaqësohen sipas një akti të rregullt nga çdo person që ata e konsiderojnë të përshtatshëm.

## NENI 15

### ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Shoqëria do të administrohet nga **Z. Roland Kocli**.

Administratori qëndron në detyrë për periudhën e caktuar nga ortakët në momentin e emërimit ose, në mungesë përcaktimi, deri në dorëheqjen ose shkarkimin e tij.

Administratori mund të shkarkohet me vendimin e favorshëm të ortakëve që përfaqësojnë më shumë se gjysmën e kapitalit themeltar ose me vendim të Gjykatës për shkelje të ligjit, mbi kërkesën e çdonjërit prej ortakëve.

Nuk mund të emërohen në detyrën e administratorit dhe nëse janë emëruar, shkarkohen, personat të cilëve u është hequr ose kufizuar aftësia për të vepruar, kanë falimentuar ose u është ndaluar, edhe përkohësisht, e drejta për të ushtruar funksione publike ose detyra drejtuese pranë personave juridikë, si rrjedhojë e një vendimi penal.

## NENI 16


### KOMPETENCAT E ORGANIT ADMINISTRATIV

Administratorët kanë të gjitha kompetencat për administrimin e zakonshëm të shoqërisë, në përputhje me sa është parashikuar nga ligji, akti themelues dhe statuti. Ata gëzojnë të drejta dhe fuqi të plota për kryerjen e çdo veprimi që vlerësojnë të dobishëm për realizimin e objektivave të shoqërisë.

Administratorët mund të delegojnë përfaqësues të posaçëm për kryerjen e akteve të veçanta ose të një kategorie aktesh, duke përcaktuar kompetencat përkatëse, të cilat në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kompetencat e përcaktuara për administratorit nga ky statut apo ligji.

Administratori ka përfaqësuesimin e Shoqërisë në marrëdhënie me të tretët si dhe para organeve të administratës dhe atyre gjyqësore.

Administratori ka këto kompetenca kryesore :



- Hartimin e inventarit, të llogarive vjetore dhe raportit me shkrim mbi administrimin, në mbylljen e çdo viti financiar;
- T'i bëjë propozimet përkatëse Asamblesë së Ortakëve kur lind nevoja për ndryshime në kapitalin themeltar të shoqërisë.
- Të miratojë aktet normative që përcaktojnë raportet në gjirin e Shoqërisë, duke përfshirë kuadrin e personelin.
- Të përcaktojë strukturën e aparatit të Shoqërisë dhe të krijojë organe të tjera të domosdoshme për realizimin e objektivave të Shoqërisë.
- T'i propozojë Asamblesë së Ortakëve krijimin e njësive dhe strukturave të ndryshme si filiale, degë e përfaqësi në qytete të tjera të vendit ose jashtë shtetit.
- Të përgatisë propozimin për mbylljen e veprimtarisë së shoqërisë dhe t'ja paraqesë Asamblesë së Ortakëve për miratim.
- Të përzgjedhë ekspertët kontabël dhe anëtarët e komisionit të likuidimit si dhe të paraqesë propozimet për miratim para Asamblesë së Ortakëve.
- Të sigurojë zbatimin e përpiktë të Vendimeve të Asamblesë së Ortakëve.
- Të përcaktojë numrin e punonjësve në Shoqëri.
- Të nënshkruajë tërheqjen e shumave monetare në llogaritë bankare deri në shumën 10.000 (dhjetë mijë) Euro.

#### NEIN 17

#### AUTORIZIMI PARAPRAK I ADMINISTRATORI

Administratori i shoqërisë është i detyruar të marrë miratimin paraparak të Ortakëve të Shoqërisë për kryerjen e veprimeve të mëposhtme:

- Transferimin e të drejtave të pronësisë së shoqërisë përfshirë këtu makineri, linja prodhimi, impiante, terren dhe të çdo lloj tjetër pronësie;
- Dhënien me qera apo në përdorim të ambjenteve të Shoqërisë;
- Të nënshkruajë tërheqjen e shumave monetare në llogaritë bankare për shuma me të mëdha se 10.000 (dhjetë mijë) Euro.

#### NENI 18

#### EKSPERTI KONTABËL

Shoqëria cakton ekspert kontabël për çdo vit financiar kur jemi përpara rasteve të përcaktuara në ligj. Caktimin e tyre e bën Asambleja e Ortakëve.

Ekspertët kontabël mbajnë përgjegjësi për mbajtjen e rregullt të të gjithë dokumentacionit të Shoqërisë. Ata përgjigjen për dëmet që i vijnë Shoqërisë nga mbajtja e parregullt e llogarive ose verifikimi i tyre i gabuar.

Nuk mund të ngarkohen me detyrën e ekspertit, themeluesi, administratori, personat që janë gjini e krushqi me ata deri në shkallën e katërt. Po ashtu nuk mund ta kryejnë këtë detyrë përgjegjësit e zyrave, filialeve e agjensive.

#### NENI 19

#### BILANCI USHTRIMOR DHE FITIMI

Viti ushtrimor mbyllet në 31 dhjetor të çdo viti.

Në fund të çdo viti ushtrimor, organi administrativ procedon me hartimin e bilancit të vitit ushtrimor, brenda afateve dhe në përputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi.

*[Handwritten signature]*

Fitimet neto që rezultojnë nga bilanci, pasi zbritet 5% (pesë për qind) që shkon për rezervë ligjore të domosdoshme, shpërndahen ndërmjet ortakëve të shoqërisë në mënyrë përpjestimore me kuotat që kanë në zotërim në kapitalin themeltar, me përjashtim të destinimit të ndryshëm të vendosur nga vetë ortakët.

#### **NENI 20**

#### **FONDET REZERVE**

Shoqëria krijon fondin rezervë dhe fonde të tjera financimi për të përballuar nevojat e saj ekonomike. Ajo disponon lirisht mjetet e veta financiare për shlyerien e detyrimeve gjatë veprimtarisë së saj.

#### **NENI 21**

#### **MBYLLJA E SHOQËRISË DHE LIKUJDIMI**

Mbyllja e parakohshme e shoqërisë vendoset nga Asamblea e ortakëve me shumicat e parashikuara për ndryshimin e këtij statuti, për një nga shkaqet e mëposhtme:

- 1- përfundim të afatit të kohëzgjatjes;
- 2- përmbushje të objektit ose pamundësi për të realizuar përmbushjen e tij, më përjashtim të rastit kur asamblea, e thirrur me urgjencë, merr vendim për kryerjen e ndryshimeve përkatëse në statut;
- 3- pamundësi të funksionimit ose mosfunksionim të vazhdueshëm të asamblesë;
- 4- zvogëlim të kapitalit themeltar nën kufirin minimal të parashikuar nga ligji;
- 5- për shkak të vendosjes së shoqërisë nën likuidim ose heqje dorë të ortakëve;
- 6- me vendim të asamblesë;
- 7- për shkaqe të tjera të parashikuara me ligj.

Në rast se verifikohet ndonjëri nga shkaqet që sjell mbylljen e shoqërisë, asamblea e ortakëve, me vendim të posaçëm që duhet marrë gjithmonë me shumicat e parashikuara për ndryshimin e statudit, do të përcaktojë modalitetet e likuidimit dhe do të emërojë një ose disa likuidatorë duke përcaktuar njëkohësisht edhe kompetencat përkatëse.

Çdo ortak ka të drejtë të marrë njoftim nga likuidatorët mbi vazhdueshmërinë e veprimtarisë së shoqërisë dhe të konsultojë librat e shoqërisë.

Shoqëria mund të anullojë në çdo moment gjendjen e likuidimit, me vendim të asamblesë të marrë me shumicat e kërkuara për ndryshimin e këtij statuti.

Aktet e mbylljes së likuidimit, së bashku me llogaritë përkatëse përfundimtare, depozitohen në Regjistrin tregtar.

Pas mbylljes së likuidimit e depozitimit të dokumentacionit në Regjistrin tregtar, Shoqëria çrregjistrohet prej tij.

#### **NENI 22**

#### **ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet ortakëve ose ndërmjet ortakëve dhe shoqërisë dhe që ka objekt të drejta të disponueshme në lidhje me marrëdhëniet e tyre me shoqërinë do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**NENI 23**  
**DISPOZITA TË FUNDIT**

Gjithçka nuk është parashikuar shprehimisht në këtë Statut do të disiplinohet nga dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

**NENI 24**

Ky Statut përpilohet në katër kopje të njëjta në gjuhën shqipe dhe, pasi iu bë e njohur palëve në gjuhën italiane prej noteres së vendit të themelimit, u nënshkrua pa vërejtje nga ortakët themelues të shoqërisë me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë.

**ORTAKËT THEMELUES**

**Paolo PANICO**

*Paolo Panico*

**Roland KOCLI**

*Roland Koçli*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA E NOTERISË TIRANË

Nr. 2239 Rep.

Nr. 419 Kol.

VËRTETIM

Sot më datë 12.01.2007 (dymbëdhjetë Janar dymijë e shtatë), para meje noteres Neriman Marika me seli në Rrugën Ded Gjon Luli, anëtare pranë Dhomës së Noterisë Tiranë, u paraqitën personalisht Paolo Panico, shtetas Italian, i datëlindjes 16 Mars 1970, lindur në Santa Marza Capua Vetere (CE), person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. F 996566 dhe Roland Kocli, shtetas shqiptar, i datëlindjes 24 dhjetor 1978, lindur dhe banues në Rrasfik, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. Z 0305980, të cilët më deklaruan përmbajtjen e këtij akti të hartuar jashtë kësaj zyre dhe të nënshkruar me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe unë noterja e vërtetova atë sipas ligjit.

NOTE RE

Neriman MARIKA

*Neriman Marika*

Taksa e Pultës  
u pagua

Përkthyes  
Florieta Bala

Z. T. Hoxha  
16 GEN. 2007

37303

KËRKESË

**KËRKUES:** *Roland Kocli*, shtetas shqiptar, i datëlindjes 24 dhjetor 1978, lindur dhe banues në Rrasfik, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. Z 0305980, me cilësinë e administratorit të Shoqërisë "ALBIT CONSTRUCTION" Sh.p.k.

**OBJEKTI:** Regjistrimi në Regjistrin Tregtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të Shoqërisë Tregtare "ALBIT CONSTRUCTION" SH.P.K.

PËRPARA GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR

*Te Regjistri Shout dt  
25-01-2007*

TIRANË

I nderuar Z. Kryetar,

*1 Kuteriga dt 12.07.2007*

Kërkuesi, nisur nga vullneti i shprehur në kontratën e themelimit, ka paraqitur përpara kësaj Gjykate kërkesën, për regjistrimin konform ligjit, në Regjistrin Tregtar të kësaj Gjykate, të Shoqërisë Tregtare "ALBIT CONSTRUCTION" Sh.p.k. me seli në adresën Rruga e Patokut Laç, dhe do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj:

- Prodhimi dhe tregtimi i materialeve të ndërtimit, si beton, granule, gëlqere, etj, i materialve inerte dhe e të gjitha materileve të tjera që përdoren në ndërtim.
- Import-eksporti i tyre brenda dhe jashtë vendit për llogari të vetë shoqërisë dhe të tretëve;

Veprimtaria e shoqërisë do të kryhet në përputhje me lejet dhe licensat e lëshuara nga organet kompetente shtetërore

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë në vlerën 100.000 (njëqindmijë) lekë me vlerë nominale të një kuote 1000 lekë. Ortakë themelues të Shoqërisë do të jenë Z. Paolo Panico dhe Z. Ronad Kocli, me këtë shpërndarje të kuotave të tyre në kapitalin fillestar:

- Z. Paolo Panico, me cilësinë e ortakut themelues, zotëron 95% të kuotave ose 95 kuota të barabarta me vlerë të përgjithshme 95.000 Lekë në kapitalin themeltar.
- Z. Roland Kocli, me cilësinë e ortakut themelues, zotëron 5% të kuotave ose 3 kuota të barabarta me vlerë të përgjithshme 5 000 Lekë në kapitalin themeltar.

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një afat kohor të pakufizuar. Administrator i Shoqërisë do të jetë Z. Roland Kocli, i cili do të ketë edhe të drejtën e përfaqësimit të Shoqërisë në lidhje me të tretët, përpara organeve gjyqësore dhe organeve të tjera administrative.

Për sa më sipër, kërkojmë nga ana e kësaj Gjykate që, pasi të gjejë me vend kërkesën tonë, të regjistrojë Shoqërinë "ALBIT CONSTRUCTION" SH.P.K. si Person Juridik.

KËRKUES

Roland KOCLI

*Roland Kocli*


*Z. T. Hoxha*  
*16 GEN. 2007*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA E NOTERISË TIRANË

Nr. 2242 Rep.

Nr.      - Kol.




VËRTETIM

Sot më datë 12.01.2007 (dymbëdhjetë Janar dymijë e shtatë), para meje noteres Neriman Marika me seli në Rugën Ded Gjon Luli, anëtare pranë Dhomës së Noterisë Tiranë, u paraqit personalisht Roland Kocli, shtetas shqiptar, i datëlindjes 24 dhjetor 1978, lindur dhe banues në Rrasfik, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i pasaportës me nr. Z 0305980, i cili më deklaroi përmbajtjen e këtij akti të hartuar jashtë kësaj zyre dhe të nënshkruar me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë dhe unë noterja e vërtetova atë sipas ligjit.

NOTE RE

Neriman MARIKA

*Notere  
Neriman Marika*





SHOQËRIA TREGTARE  
"ALBIT CONSTRUCTION" SH.P.K.

Tiranë më 12.01.2007

AUTORIZIM

Unë i nënshkruari Roland Kocli, në cilësinë e administratorit të Shoqërisë Tregtare në regjistrim e sipër "ALBIT CONSTRUCTION" Sh.p.k., me anë të këtij autorizimi, autorizoj avokatet e Studios së Avokatisë HAXHIA & HAJDARI, Av. Eris Hysi dhe/ose Av. Jonida Gaba, për të kryer të gjitha veprimet ligjore dhe për të ndjekur procedurat e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë në Regjistrin Tregtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Av. Eris Hysi dhe/ose Av. Jonida Gaba kanë të drejtë të dyja së bashku ose secila veç e veç që të përpilojnë dhe firmosin dokumentet dhe paraqesë ato në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe të ndërmarrin të gjitha veprimet juridike që ato i konsiderojnë të nevojshme për regjistrimin e Shoqërisë Tregtare "ALBIT CONSTRUCTION" Sh.p.k. në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Të gjitha veprimet e kryera nga Av. Eris Hysi dhe/ose Av. Jonida Gaba për përmbushjen e qëllimit të këtij autorizimi do të konsiderohen të drejta sikur të ishin kryer prej administratorit të shoqërisë.

ADMINISTRATOR

Roland KOCLI

*Roland Kocli*



Banka Popullore

---

**Dega LAÇ**

Nr.Prot 261

**Laç më: 15.01.2007**

**KONFIRMIM BANKAR**

Ju konfirmojmë se:ALBIT CONTRUCTION SHPK ka  
ngurtesuar shumen 100.000LEKE ne llogarine me nr:47335 prane  
Bankes Popullore dega Lac per capital fillestar.

Shan TOTA  
Drejtore e Deges  
BANKA POPULLORE  
15.01.2007  
DEGA LAC